RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT – SHQIPËRIA 2014

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Shqipërisë është një demokraci parlamentare. Kushtetuta ia vesh autoritetin legjislativ parlamentit (Kuvendit) me një dhomë, i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri drejton qeverinë, ndërkohë që presidenti ka pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në qershor 2013, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare që Zyra për Institucionet Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriu (ODIHR) e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) i cilësoi konkuruese dhe që respektuan liritë themelore por që u zhvilluan në një klimë mosbesimi që njollosi mjedisin zgjedhor. Autoritetet ruajtën kontroll të efektshëm të forcave të sigurisë.

Problemet më domethënëse të të drejtave të njeriut ishin korrupsioni i përhapur në të gjitha degët e qeverisjes, sidomos brenda sistemeve të gjyqësorit dhe kujdesit shëndetësor, si dhe dhuna në familje dhe diskriminimi kundër grave.

Probleme të tjera të të drejtave të njeriut përfshinë rrahjen ose keqtrajtimet nga policia gjatë ndalimit dhe marrjes në pyetje, hera-herës për të nxjerrë rrëfime; ndalimet me raste të zgjatura të policisë pa pasur akuza; kushtet nën standarde të burgjeve; si dhe një gjyqësor joeficient të prekur nga trysnia politike dhe korrupsioni. Qeveria bëri pak përparime në trajtimin e pretendimeve për kthimin ose kompensimin e pronave të marra gjatë ish periudhës komuniste, dhe shumë prej pretendimeve për pronat mbetën të pazgjidhura. Një raport shpërpjestimisht i lartë i lindjeve meshkuj-femra nënkuptonte se mund të ishte duke ndodhur pëzgjedhje e seksit me bazë gjinore. Vazhduan shenjat për abuzim të përhapur gjerësisht të dhunës ndaj fëmijëve, edhe pse ishte e nënraportuar. Kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë rruge, sidomos brenda komunitetit rom, edhe pse qeveria bëri përpjekje më të mëdha për ta trajtuar problemin gjatë vitit. Vendi vazhdoi të ishte një vend burimi dhe destinacioni për burra, gra dhe fëmijë që i nënshtroheshin trafikimit për qëllime seksi dhe punës së detyruar. Margjinalizimi dhe abuzimi i komuniteteve rome dhe ballkano-egjiptiane ishin probleme serioze ashtu si dhe diskriminimi i bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Vënia në zbatim nga qeveria e ligjeve të punës mbeti e dobët dhe rrallë arrinte të mbronte punëtorët e shtëpive dhe ata migrues. Një numër i madh fëmijësh angazhoheshin në punë të detyruar. Pati raportime për diskriminim në punësim ose punë ndaj individëve bazuar në gjininë, praninë e një paaftësie, orientimit seksual ose identitetit gjinor, kombësisë dhe etnisë.

Pandëshkueshmëria mbeti problem. Ndjekja penale dhe dënimi i zyrtarëve që kryenin shkelje mbeti sporadike dhe jokonseguente, edhe pse qeveria i intensifikoi përpjekjet e saj për të hetuar zyrtarë të dyshuar për të tilla shkelje. Zyrtarët qeveritarë dhe politikanët, si dhe gjyqtarë dhe ata me interesa të fuqishme biznesi, shpesh ishin në gjendje të shmangnin ndjekjen penale. Disa zyrtarë të niveleve të ulëta u ndëshkuan për shkelje. Qeveria inicoi hetime për disa zyrtarë të nivelit të lartë, por prokuroria më pas i pushoi çështjet.

Seksioni 1. Respekti për Integritetin e Personit, Përfshi Lirinë nga:

a. Mohimi Arbitrar ose i Jashtëligjshëm i Jetës

Nuk pati raportime se qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të jashtëligjshme.

Pandëshkueshmëria lidhur me vrasje të mëparshme mbeti problem. Në shtator, prokurorët ngritën akuza ndaj ish drejtorit të përgjithshëm të policisë Hysni Burgaj dhe ish zëvendësit të tij Agron Kulicaj për abuzim me detyrën pasi policia kishte refuzuar të ekzekutonte urdhërat e arrestimit për oficerët e Gardës së Republikës që kërkoheshin në lidhje me vrasjen e protestuesve në vitin 2011.

Deri në Shtator, çështjet kundër anëtarëve të Gardës së Republikës Ndrea Prendi dhe Agim Llupo, akuzuar për vrasjet e katër protestuesve në vitin 2011, ishin në Gjykatën e Lartë. Gjykata po merrte në konsideratë apelimet nga prokuroria të dënimeve me një dhe me tre vjet kundër dy të pandehurve në vitin 2013 nga një gjykatë apeli, e cila kishte liruar një të dyshuar të tretë.

Qeveria vazhdoi të bashkëpunonte me hetimet e Task-Forcës së Posaçme Hetimore të BE-së për pretendimet se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe të lidhur me të kishin ndaluar "të burgosur lufte" civilë nga Kosova në vende të ndryshme në Shqipëri, i kishin mbajtur në kushte çnjerëzore, se i kishin vrarë midis vitit 1999 dhe mesit të vitit 2000, dhe mës pas kishte trafikuar organet e tyre.

Incidentet e vrasjeve shoqërore, përfshi si "gjakmarrjet" ashtu dhe vrasjet për hakmarrje, vazhduan gjatë vitit. Hera-herës, vrasje të tilla përfshinin banda kriminale. Edhe pse traditat shumëvjeçare të gjakmarrjes e ndalonin vrasjen e fëmijëve dhe grave, organizatat joqeveritare (OJQ) raportuan raste në të cilat autorët qëllimisht kishin vënë në shënjestër minorenë ose femra. Avokati i Popullit raportoi se përpjekjet e autoriteteve për të mbrojtur familjet ose për të parandaluar vrasjet për gjakmarrje kishin qenë të pamjaftueshme.

Policia raportoi katër vrasje për gjakmarrje gjatë gjashtë muajve të para të vitit. OJQ të tjera raportuan shifra më të larta, por të dhënat nuk ishin të besueshme. Në vitin 2013, qeveria ndryshoi ligjin për të rritur ndëshkimet për vrasje me paramendim, kur kryhen për gjakmarrje, nga 20 vite burgim në jo më pak se 30 vite burgim. Juridiksoni për rastet e gjakmarrjes u kalua nga gjykatat e rretheve në gjykatat e krimeve të rënda.

Amnesty International i nxiti autoritetet të kthenin trupin e Remzi Hoxhës, i cili ishte zhdukur në vitin 1995, siç pretendohet me përfshirjen e forcave të sigurisë, tek familja dhe t'u ofronin atyre informacion për fatin e tij.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje, marrje apo rrëmbime të motivuara politikisht.

c. Tortura dhe Trajtime ose Ndëshkime të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese
Ndërkohë që kushtetuta dhe ligji i ndalojnë veprime të tilla, policia dhe rojet e burgjeve me raster rahën dhe abuzuan të dyshuarit dhe të ndaluarit. OJQ-të dhe Avokati i Popullit nuk raportuan ndonjë abuzim të motivuar nga përkatësia politike apo fetare.

Deri në qershor, shërbimi i kontrollit të brendshëm i policisë kishte marrë tri ankesa për sjellje abusive nga personeli i policisë gjatë vitit.

Ligji mandaton që Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, të monitorojë dhe raportojë për burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Gjatë vitit, Avokati i Popullit dhe OJQ-të raportuan se kushtet në shumicën e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit u përmirësuan, ndonëse mbetën problem serioze në disa mjedise. Deri në gusht, Avokati i Popullit kishte marrë 103 ankesa nga të paraburgosur që pretendonin se oficerët e policisë i kishin abuzuar fizikisht, i kishin ndaluar në mënyrë të paligjshme, kishin kryer kontroll në mënyrë të jashtëligjshme, ose i kishin gjobitur në mënyrë të paligjshme; kishin shkelur privatësinë e tyre; ose kishin dështuar që t'iu jepnin informacionin e e nevojshëm. Avokati i Popullit i gjeti 30 nga këto ankime të justifikuara, 37 të pajustifikuara dhe tre jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit ishte duke shqyrtuar edhe 33 ankesa të tjera. Avokati i Popullit po ashtu raportoi kushte të këqija jetese në shumë mjedise dhe mungesën e vëmendjes së duhur mjekësore për të burgosurit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi se policia disa herë kishte përdorur forcë të tepërt ose se kushtet në mjedise të caktuara paraburgimi ishin aq të këqija sa përbënin trajtim çnjerëzor. Shumica e ankesave që merrte KSHH pretendonin se policia kishte ndaluar persona pa justifikim kishte ndaluar persona përtej kufijve ligjorë, kishte vonuar transferimin e tyre në mjedise paraburgimi, kishte dështuar t'iu bënte të ditura të drejtat e tyre, ose iu kishte mohuar akses në një avokat. Pati edhe ankesa për tejmbushje. KSHH deklaroi se policia shpesh raportonte që të ndaluarit që pretendonin abuzime arrinin me lëndime. Autoritetet nuk mbanin regjistra të përshtatshme mjekësore, duke e bërë të vështirë që të ndaluarit të vërtetonin se lëndimet e tyre kishin ndodhur gjatë ndalimit.

OJQtë raportuan se trajtimet nga policia dhe autoritetet e burgjeve të minorenëve dhe grave të ndaluara ishin përmirësuar krahasuar me vitin 2013. OJQtë raportuan më pak ankime nga të ndaluar minorenë lidhur me abuzim fizik ose dhunë brenda qendrave të paraburgimit dhe burgjeve, edhe pse raportimet vazhduan që hera herës autoritetet dështonin t'i merrnin të tilla probleme seriozisht.

Kushtet në Burgje dhe Qendra Paraburgimi

Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi varionin shumë në varësi të mjediseve. Vendi ishte në procesin e zëvendësimit të disa mjediseve më të vjetra në të cilat kushtet ishin të ashpra dhe përbënin kërcënim për jetën, ndërsa mjediset më të reja, ndërtuar pas vitit 1991 përgjithësisht përmbushnin standardet ndërkombëtare. Kushtetnën kontrollin e Ministrisë së Drejtësisë ishin përgjithësisht më të mira se sa ato nën kontrollin e

Ministrisë së Brendshme. Gjatë vitit, Avokati i Popullit deklaroi që kushtet në burgun Jordan Misja të Tiranës e bënin atë të papërshtatshëm për të burgosurit.

Kushtet fizike: Deri në shtator, kishte 2,961 persona në qendra paraburgimi dhe 2, 596 persona të dënuar në burgje, përfshi 93 të burgosura femra dhe 106 minorenë. Kushtet në burgjet dhe qendrat e paraburgimit për femra ishin përgjithësisht më të mira se sa në mjediset për meshkuj.

Deri në shtator, Zyra e Avokatit të Popullit raportoi se nuk kishte marrë ndonjë njoftim për vdekje të dyshimtë në burgje apo qendra paraburgimi. Qeveria raportoi pesë vdekje në burg deri në shtator.

Mjediset më të vjetra kishin kushte johigjenike dhe shpesh iu mungonin kushtet bazë, përfshi akses në ujë të pijshëm, pastërti, ventilim, ndriçim dhe kujdes shëndetësor. Tejmbushja ishte problem, sidomos në qendrat e paraburgimit. Rojet dhe të tjerë të burgosur keqtrajtuan të burgosur dhe të ndaluar, duke kërcënuar jetët dhe shëndetin e tyre. Avokati i Popullit dhe KSHH raportuan se të ndaluarit dhe të burgosurit nuk kishin akses të përshtatshëm në kontrolle mjekësore dhe të tjera shërbime. Avokati i Popullit dhe OJQtë raportuan se autoritetet ndalonin personat e dënuar që vuanin nga probleme të shëndetit mendor në burgje të zakonshme, ku aksesi në kujdes për shëndetin mendor ishte tërësisht i pamjaftueshëm.

Ministria e Brendshme administronte stacionet e policisë dhe qendrat e ndalimit të përkohshëm. Kushtet në ato mjedise ishin plotësisht të pamjaftueshme, me përjashtim të drejtorisë rajonale të policisë dhe qendrës së saj të paraburgimit Tiranë, të cilën qeveria e rindërtoi gjatë vitit. Në disa raste, mjediset e ndalimit ishin pa ngrohje gjatë dimrit. Disave iu mungonin kushtet higjenike bazë, të tilla si dushe apo lavamanë, ishin të mbushura, ofronin akses të kufizuar në tualete dhe kishin pak ose aspak ventilim, dritë natyrale ose krevate dhe stola. Qeveria nuk bëri investim të mjaftueshëm kapital në insfrastrukturën e policisë, përfshi mjediset e ndalimit, gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar.

Administrimi: OJQtë vërejtën se mbajtja e regjistrave në disa institucione nuk ishte e mjaftueshem, sidomos në stacionet e vogla ose rurale të policisë. Qendra Shqiptare e Rehabilitimit nga Trauma dhe Tortura raportoi se, sipas të dhënave të policisë për vitin 2013, autoritetet kishin dështuar në përfshirjen e 210 nga 2,266 regjistrimet penale në sistemin kombëtar elektronik. Të burgosurit dhe të ndaluarit kanë të drejtën të takohen ose të marrin telefonata nga të afërmit. Takimet mund të ndodhin deri në katër herë në muaj për të rriturit dhe deri në tetë herë për minorenët, dhe autoritetet lejojnë tetë telefonata në muaj. Të burgosurit dhe të ndaluarit ishin të lirë të praktikonin fenë e tyre, dhe disa mjedise kishin hapësira të posaçme për shërbime fetare. Të burgosurit dhe të ndaluarit mund të paraqisnin ankime tek Avokati i Popullit dhe tek autoritetet gjyqësore dhe administrative. Çdo qendër penale kishte një kuti postare ku të burgosurit dhe të ndaluarit mund të paraqisnin ankesa pa u censuruar. Të burgosurit mund të takoheshin konfidencialisht me Avokatin e Popullit, Komisionin Mbikqyrës të Burgjeve, ose OJQ të huaja dhe vendase për të drejtat e njeriut. Vendi përdorte alternativa për burgosjen dhe dënimet.

Autoritetet hetuan pretendime të besueshme për kushte çnjerëzore dhe dokumentuan rezultatet e hetimeve të tyre. Avokati i Popullit raportoi se zyrtarët e burgjeve përgjithësisht bashkëpunonin me hetimet e tyre; megjithatë, burgjet nuk zbatonin plotësisht rekomandimet e Avokatit të Popullit. OJQtë raportuan se edhe pse qeveria i merrte sugjerimet e tyre më seriozisht se në të kaluarën, vazhdonte të refuzonte hetimin e disa rasteve. Avokati i Popullit gjeti se korrupsioni ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit, sidomos në programet e lejeve të posaçme.

Monitorimi i Pavarur: Qeveria lejoi grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, si dhe organ endërkombëtare të tilla si Komiteti i Këshillit të Europës për Parandalimin e Torturës që të monitoronin kushtet e burgjeve. Megjithatë, Avokati i Popullit raportoi se në disa raste policia refuzoi t'i lejonte vëzhguesit të hynin në qendrat e paraburgimit pa miratim paraprak nga policia.

Përmirësime: në prill, parlamenti miratoi një ligj që përcakton të drejtat e të ndaluarve dhe standardet për trajtimin e tyre, përfshi trajtimin e përshtatshëm mjekësor në burgje. OJQtë raportuan ndjeshmëri më të lartë ndaj të drejtave të të ndaluarve minorenë dhe femra. Avokati i Popullit raportoi se autoritetet ishin më fleksibël në lejimin e minorenëve në qendrat e paraburgimit që të takoheshin me të afërmit. Qeveria vazhdoi ndërtimin e dy burgjeve të rinj dhe dy qendrave të reja të paraburgimit. Në përgjigje të kritikave për mbajtjen e pamjaftueshme të regjistrave, policia përmirësoi menaxhimin e regjistrave nëpërmjet zbatimit të vazhduar të një sistemi elektronik.

d. Arrestimi ose Ndalimi Arbitrar

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto kërkesa.

Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurisë

Ministria e Brendshme mbikqyr Policinë e Shtetit dhe Gardën e Republikës. Policia e Shtetit është organizata kryesore përgjegjëse për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë shtetërorë, personalitetet e huaj, si dhe prona të caktuara shtetërore. Ministria e Mbrojtjes mbikqyr forcat e armatosura, të cilat ndihmojnë popullsinë në raste nevojash humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) grumbullon informacion dhe kryen veprimtari të zbulimit dhe kundërzbulimit të huaj.

Autoritetet civile përgjithësisht mbajtën kontroll të efektshëm të policisë, Gardës së Republikës, forcave të armatosura dhe SHISH, ndonëse periodikisht burimet shtetërore u përdorën për përfitime personale dhe anëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime.

Policia nuk e zbatoi gjithmonë në mënyrë të barabartë ligjin. Lidhjet personale, lidhjet politike apo kriminale, infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve, ose mbikqyrja e pamjaftueshme shpesh ndikonin zbatimin e ligjeve. Pagat e ulëta, motivimi dhe drejtimi i

dobët, si dhe mungesa e diversitetit në forcat e punës kontribuan për korrupsion dhe sjellje joprofesionale të vazhduar. Pandëshkueshmëria mbeti problem serioz, ndonëse qeveria bëri përpjekje më të mëdha për ta trajtuar atë.

Korrupsioni në radhët e policisë ishte problem (shih seksioni 4).

Qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar abuzimin dhe korrupsionin. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm i qeverisë kreu audite, iu përgjigj ankesave dhe kreu hetime me një theks të shtuar tek të drejtat e njeriut, kushtet e burgjeve dhe respektimi i procedurave standarde të punës. Gjatë vitit, Avokati i Popullit trajtoi ankesa kundër oficerëve të policisë, kryesisht lidhur me probleme me arrestime dhe ndalimet. Deri në shtator, Avokati i Popullit kishte marrë 103 ankesa dhe kishte hetuar ose ofruar këshilla në përgjigje të 70 prej tyre. Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, raportoi zbatim në rritje të rekomandimeve të tij lidhur me keqtrajtimin.

Komisioni Europian raportoi se gjatë vitit, qeveria rriti pagat e policëve dhe ngriti një konkurim të hapur për rekrutët e rinj. Deri në gusht, autoritetet kishin marrë në punë 400 rekrute të reja femra. Në qershor, policia kishte kryer një operacion të suksesshëm kundër një zone kryesore të prodhimit të drogës. Ndryshe nga përpjekje të ngjashme në të kaluarën, policia demonstroi profesionalizëm më të madh duke iu përgjigjur zjarrit nga kriminelët dhe duke i mundur ata pa lënduar as të dyshuarit dhe as civilët.

Procedurat e Arrestimit dhe Trajtimi i të Ndaluarve

Kushtetuta kërkon që një gjykatës të lëshojë një mandate për arrestimin e një të dyshuari bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk pati raportime për arrestime të fshehta. Me ligj, policia duhet të informojë menjëherë prokurorin për një arrestim. Prokurori mund ta lëshojë të dyshuarin ose t'i drejtohet gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur të ndaluarin më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orëve nëse duhet ta vendosë të dyshuarin në arrest, ta lirojë me kusht, t'i ndalojë udhëtimin, ose t'i kërkojë të pandehurit të paraqitet rregullisht në polici. Në shumë çështje penale, prokurorët kërkuan arrest me burg dhe gjykata e urdhëroi atë. Megjithatë, gjykatat në mënyrë rutinë i mohonin kërkesat e prokurorëvepër ndalimin e të pandehurve me lidhje të forta ose të profilit të lartë.

Kushtetuta kërkon që autoritetet t'i informojnë personat e ndaluar për akuzat kundër tyre dhe të drejtat e tyre. Autoritetet e zbatimit të ligjit nuk e respektuan gjithmonë këtë kërkesë. Nuk kishte një sistem të efektshëm për trajtimin e aspektit monetar të lirimit me kusht. Në vend të kësaj, gjykatat shpesh urdhëronin që të dyshuarit të paraqiteshin pranë policisë ose prokurorëve çdo javë. Ndërkohë që ligji iu jep të ndaluarve të drejtën për akses të menjëhershëm në një avokat, me shpenzime publike nëse ka nevojë, OJQtë raportuan se shpesh marrjet në pyetje ndodhnin pa praninë e një avokati. Autoritetet i vendosnin shumë të dyshuar në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e këtyre të fundit sepse nëse dënoheshin, përfitonin nga koha e kaluar në arrest shtëpiak. Zyrtarët nuk monitoronin në mënyrë të efektshme arrestin shtëpiak dhe të dyshuarit mund të lëviznin jashtë lehtësisht pa u pikasur.

Me ligj, policia duhet t'i transferojë të ndaluarit nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për ndalime afatgjata, nëse ndalimi i tyre i kalon 10 orë. Për hskak të komunikimit të dobët mes ministrive, kjo ndodhte rrallë, dhe ishte e zakonshme që të ndaluarit, përfshi minorenë, të mbeteshin në qendra paraburgimi për periudha të gjata.

Arresti Arbitrar: Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar. Ndonëse qeveria përgjithësisht i respektonte këto ndalime, kishte raste kur policia ndalonte persona për t'i marrë në pyetje për kohë të gjatë pa i arrestuar formalisht. Nuk pati raportime se rastet e ndalimeve të zgjatura të ishin bazuar në përkatësinë politike apo besimin fetar të individëve.

Paraburgimi: Ndërkohë që ligji kërkon kryerjen e shumicës së hetimeve para gjyqit brenda tre muajsh, prokurori mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vjet ose më shumë. Ligji parashikon që paraburgimi maksimal nuk duhet të kalojë tri vjet; nuk pati raportime se autoritetet e kapërcyen këtë kufi gjatë vitit. Parandalimi i zgjatur shpesh ndodhte për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve të mbrojtjes, ose dështimit të qëllimshëm të avokatit mbrojtës për t'u paraqitur. Me ligj, gjykatësi nuk mund t'i parandalojë veprime të tilla vonuese duke akuzuar avokatin se shpërfill gjykatën. Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, menaxhimi i dobët i kalendarit të gjykatës, dhe dështimi i avokatëve dhe dëshmitarëve për t'u paraqitur e pengonin gjykatën që t'i gjykonte çështjet në kohë. Deri në tetor 2013, 40 përqind e popullsisë së burgjeve dhe paraburgimeve ishin në fazën e paraburgimit para gjyqit.

Ndalimi i Azil-Kërkuesve të Refuzuar ose Personave pa Shtetësi: Autoritetet ndalonin migrantët që hynin në vend në mënyrë të jashtëligjshme. Policia refuzoi t'i lejonte përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKBsë për Refugjatët (UNHCR) që të monitoronin përpunimin, ndalimin, dhe deportimin e disa migrantëve.

Në një rast, disa migrantë, kryesisht me origjinë nga Eritrea, pretenduan se policia kishte shkelur rregullat për process të rregullt duke iu mohuar të drejtën për të kërkuar azil duke i mbajtur në një qendër ndalimi për tetë muaj. UNHCR ndërhyri në emër të tyre nëpërmjet sistemit të gjykatave. Deri në shtator, gjykatat kishin vendosur në favor të dy prej migrantëve, duke refuzuar urdhërat e policisë për deportimin e tyre.

e. Ndalimi i Gjyqit të Drejtë Publik

Ndonëse kushtetuta siguron një gjyqësor të pavarur, presioni politik, kërcënimi, korrupsioni i përhapur dhe burimet e kufizuara hera-herës nuk e linin gjyqësorin të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Seancat e gjyqeve shpesh nuk ishin të hapura për publikun. Oficerët e sigurisë të gjykatave shpesh refuzonin të lejonin vëzhgues që të ndiqnin seancat dhe në mënyrë rutinë i telefononin gjykatësve për të pyetur nëse mund të lejonin një individ që kërkonte të ndiqte një seancë të caktuar. Disa agjenci demonstronin një model injorimi ndaj urdhrave të gjykatës. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese kërcënonte të minonte

pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve. Deri në shtator, dy vende bosh në Gjykatën e Lartë mbetën bosh pas afro një viti me gjithë një numër të konsiderueshëm çështjesh të mbartura që qëndronin përpara gjykatës.

Komisioni Europian raportoi në qershor se, prej tetorit të mëparshëm, Ministri i Drejtësisë kishte iniciuar procedim disiplinor ndaj 19 gjykatësve. Në një rast, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte shkarkuar gjykatësin, në një tjetër kishte transferuar gjykatësin në një gjykatë më të ulët për dy vjet, dhe në tre të tjera kishte nxjerrë paralajmërime pr shkarkim të mundshëm. Deri në shtator, Këshilli i Lartë i Drejtësisë po merrte në shqyrtim akuzat kundër 14 gjykatësve të mbetur.

Procedurat e Gjyqit

Ligji i prezumon të pandehurit të pafajshëm deri sa të jenë dënuar. Ligji garanton që të pandehurit të informohen menjëherë dhe me hollësi për akuzat, me përkthim falas nëse ka nevojë, si dhe që të kenë një gjyq të drejtë dhe publik pa vonesa të paarsyeshme. Sistemi i gjykatave nuk parashikon gjyqet me juri. Të pandehurit kanë të drejtën të konsultohen me një avokat dhe që t'iu ofrohet një i tillë me shpenzime publike nëse nuk e përballojnë dot. Ligji garanton për të pandehurit kohë dhe mundësi të mjaftueshme për t'u përgatitur për mbrojtjen dhe të drejtën për të pasur akses në provat që ka prokuroria. Të pandehurit kanë të drejtën të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova për mbrojten e tyre. Të pandehurit nuk mund të detyrohen që të dëshmojnë ose të pranojnë fajin. Të pandehurit kanë të drejtën e apelimit. Qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta edhe pse gjyqet nuk ishin gjithmonë publike dhe aksesi në një avokat ndonjëherë ishte problematik. Megjithë të drejtën statutore për këshillim ligjor falas, OJQtë raportuan se shumë pak individë përfituan nga ligji gjatë vitit.

Në një numër vendimesh kundër shtetit, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) kishte kritikuar procedurat e gjyqeve. Në veçanti, GJEDNJ vërente se autoritetet ndonjëherë dështonin të siguronin ose të regjistronin si duhet provat e dëshmitarëve, përdornin prova të siguruara me torturë, dhe dështonin t'iu ofronin të ndaluarve akses në një avokat.

Të Burgosur dhe të Ndaluar Politikë

Nuk pati raportime për të burgosur ose të ndaluar politikë.

Personat që kishin qenë të burgosur politikë nën ish-regjimin komunist vazhdonin të kërkonin kompensim nga qeveria. Në disa raste gjatë vitit, grupe ish të burgosurish politikë protestuan kundër dështimit të qeverisë për t'iu paguar kompensim të mandatuar ligjërisht, përfshi edhe me anë të grevave të urisë. Në korrik, parlamenti miratoi amendamente në ligjin për kompensimin për t'iu dhënë përparësi grave, të moshuarve, atyre me sëmundje serioze, si dhe atyre që nuk kishin marrë kurrë asnjë pagesë. Qeveria bëri përparim me disbursimin e kompensimit gjatë vitit, por Avokati i Popullit pohoi se ligji kishte dështuar në përcaktimin e një afati të përshtatshëm për plotësimin e pagesave të kompensimit dhe OJQtë e kritikuan se nuk kishte trajtuar çështje më të mëdha, të tilla si

hapja e dosjeve të ish-komunizmit, nisjen e një procesi pajtimi kombëtar, dhe ngritjen e një regjistri zyrtar për persekutimin e ish-viktimave, shumica e të cilave ishin të moshuar.

Procedurat dhe Zgjidhjet Gjyqësore Civile

Ndërkohë që individët dhe organizatat mund të kërkojnë zgjidhje civile për shkelje të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin të prekshme nga korrupsioni, mungesa e eficiencës, kërcënimet dhe ndërhyrjet politike. Gjykatësit i kryenin shumë seanca gjyqesh në zyrat e tyre, duke demonstruar mungesë profesionalizmi dhe duke ofruar mundësi për korrupsion. Këta faktorë minuan autoritetin e gjyqësorit, kontribuan për vendime të diskutueshme gjykatash dhe çuan në aplikimin jokonseguent të ligjit.

Vendime të Gjykatave Rajonale të të Drejtave të Njeriut

Shtetasit mund të apelonin vendimet lidhur me shkelje të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nga shteti pranë GJEDNJ. Deri në shtator, 37 gjykime të GJEDNJ kundër shtetit nuk ishin zbatuar. Gjykimet trajtonin 17 probleme kyçe, nga të cilat tri më seriozet ishin dështimi për të zbtuar vendime vendase gjyqësore dhe administrative lidhur me kthimin e pronës, procedura të padrejta penale, si dhe mungesa e trajtimit të përshtatshëm mjekësor në burg. Një studim i vitit 2013 nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Fondacioni Soros kishte gjetur se avokatët, prokurorët dhe gjykatësit kishin dije të kufizuara për jurisprudencën e GJEDNJ.

Kompensimi i Pronës

Një numër i madh pretendimesh kundërshtuese për prona private dhe fetare të konfiskuara gjatë epokës komuniste mbetën të pazgjidhura. Ekspertët e Bankës Botërore deklaruan se, duke pasur parasysh ritmin e ulët të kthimit, qeverisë do t'i duheshin 38.6 miliardë dollarë dhe 30 vjet për ta përfunduar procesin. Deri në shtator, mbi 7,000 çështje kthimi pronash prisnin zgjidhnje në Agjencinë shtetërore për Kthimin e Pronës. Në korrik, GJEDNJ refuzoi kërkesën e autoriteteve për të shtyrë afatin e saj të qershorit për ngritjen e një mekanizmi të efektshëm për të kompensuar ish pronarët për pronat e tyre. GJEDNJ nxori vendime në një numër çështjesh të profilit të lartë që kërkonin nga qeveria t'u paguante paditësve dhjetëra miliona dollarë si kompensim për prona të konfiskuara. Deri në shtator, qeveria kishte miratuar katër vendime për ekzekutimin e gjykimeve të GJEDNJ të cilat kërkonin kompensimin financiar të pretenduesve. Megjithatë, disbursimi i fondeve mbeti i pasigurt deri në shtator.

Në vitin 2013, një zyrë përmbarimi privat nxori 14 familje nga një kompleks apartamentesh në Tiranë, sipas pretendimeve në zbatim të një urdhëri gjykate që urdhëronte kthimin e pronës tek pronari përpara epokës komuniste. Familjet filluan një grevë urie duke kërkuar që qeveria t'u gjente zgjidhje dhe prokuroria e Tiranës filloi ndjekje penale kundër agjencive të qeverisjes së qytetit që kishin nxjerrë urdhrin fillestar të gjykatës. Familjet e dëbuara filluan procedim civil kundër zyrës së përmbarimit privat. Në qershor, prokuroria e Tiranës e pushoi çështjen.

f. Ndërhyrja Arbitrare në Privatësi, Familje, Banesë ose Korrespondencë

Pati raportime të besueshme se qeveria shkatërroi disa shtëpi pa process të rregullt ligjor si pjesë e një fushate më të gjerë për të shkatërruar ndërtesa të ndërtuara në mënyrë të jashtëligjshme. Qytetarët po ashtu paraqitën ankesa se qeveria, nëpërmjet Inspektoratit të Ndërtimit Urbanistik Kombëtar, injoroi kërkesat e qytetarëve për të shkatërruar disa ndërtesa të paligjshme ndërkohë që zgjodhi të shkatërronte të tjera ndërtesa për të cilat qytetarët nuk ishin ankuar. Deri në shtator, Avokati i Popullit po kryente vlerësimin e këtyre pretendimeve.

Në dhjetor 2013, qeveria qendrore shkatërroi një ndërtesë apartamentesh në Vlorë, edhe pse banorët zotëronin tituj pronësie. Avokati i Popullit i kishte përshkruar përpjekjet e mëparshme të qeverisë për t'i ndaluar banorët të hynin në pronë si të paligjshme dhe gjykata e rrethit kishte vendosur në favor të banorëve. Qeveria pretendoi se ndërtimi ishte i paligjshëm. Këshilli i Ministrave vendosi t'i kompensonte ish-banorët e ndërtesës por deri në shtator nuk e kishte bërë këtë.

Seksioni 2. Respekti për Liritë Civile, Përfshi:

a. Lirinë e Fjalës dhe Shtypit

Kushtetuta siguron lirinë e fjalës dhe të shtypit dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta. Pati raportime që qeveria dhe bizneset u përpoqën të ndikonin median në mënyra të papërshtatshme.

Liritë e Shtypit: Media e pavarur ishte aktive dhe kryesisht e pakufizuar, ndonëse kishte raste të ndikimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë politik dhe ekonomik mbi median, përfshi duke kërcënuar gazetarët. Presioni politik, korrupsioni dhe mungesa e financimeve kufizuan median e shkruar të pavarur dhe gazetarët raportuan se praktikonin auto-censurë. Partitë politike, sindikatat dhe grupe të tjera botonin gazeta ose revista në mënyrë të pavarur nga ndikimi i qeverisë.

Në Indeksin e Qëndrueshmërisë së Medias, organizata IREX vërejti se pavarësia e medias në vend mbeti e njëjtë si gjatë vitit 2013.

Pavarësia e Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA), rregullatori i tregut të medias elektronike, mbeti e dyshimtë. Një mosmarrëveshje e politizuar lidhur me drejtimin e AMAs dhe përbërjen e bordit të saj pengoi aftësinë e saj për të përmbushur mandatin e vet. Përparimi i vendit drejt një kalimi të planifikuar për qershorin 2015 në transmetimet numerike u pengua nga ngecja politike dhe një padi nga transmetuesit që pretendonin se AMA kishte marrë një vendim pa kuorumin e kërkuar. Pati raportime të besueshme se ndikimi i operatorëve komercialë kufizoi përpjekjet e Kuvendit për të plotësuar dhe reformuar AMAn dhe transmetuesin publik.

Transmetuesi i vetëm publik i vendit, Radio Televizioni Shqiptar, administronte një kanal televiziv kombëtar dhe një radiostacion kombëtar dhe me ligj merrte 50 përqind të buxhetit të tij nga fondet publike. Mosmarrëveshjet midis partive politike e penguan transmetuesin publik që të plotësonte postet e larta.

Ndërkohë që stacionet private funksiononin përgjithësisht të lira nga ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë, shumica e pronarëve besonin se përmbajtja e transmetimeve të tyre mund të ndikonte veprimet e qeverisë ndaj bizneseve të tjera të tyre, ndonëse më pak se në të kaluarën. Po ashtu, pronarët e bizneseve i përdornin lirisht mediat për të siguruar favore dhe për të promovuar interesat e tyre me të dyja partitë kryesore.

Disa organe të medias vazhduan të prodhonin lajme investigative, të cilat hera-herës çuan në shkarkime dhe çështje penale kundër zyrtarëve të korruptuar publikë. Transparency International raportoi se në vitin 2013 media kishte luajtur një rol më të madh se sa në vite të mëparshme për ekspozimin e rasteve të korrupsionit dhe abuzimit të detyrës publike.

Dhuna dhe Ngacmimet: Pati incidente dhune kundër anëtarëve të medias gjatë vitit, dhe aktorët politikë dhe të biznesit ushtruan presion ndaj gazetarëve.

Pati raportime të besueshme se Telnis Skuqi, një reporter për të përditshmen *Rilindja Demokratike*, kishte marrë një mesazh telefonik që e kërcënonte me dhunë ndaj tij pas botimit të një artikulli që kishte shkruar ku pretendonte se zyrtarë të qeverisë ishin të përfshirë në trafik droge. Ai e mori mesazhin nëpërmjet internetit nga një dërgues anonim. Sipas raporteve të besueshme, policia në Gjirokastër dhe Tiranë i ofruan mbrojtje Skuqit, por ky nuk e kishte pranuar.

Më 12 prill, policia detyroi reporterin Armand Bajrami të gazetës së përditshme *Panorama* të fshinte fotot që iu kishte bërë oficerëve të policisë që rrihnin një të ri. Viktima kishte marrë pjesë në çka autoritetet e quanin një protestë të jashtëligjshme përpara ambasadës greke në Tiranë. Media raportoi se policia i kërkoi ndjesë Bajramit dhe se katër oficerët e përfshirë në incident ishin pezulluar. Pas ndjesës publike, drejtori i përgjithshëm i policisë dhe drejtori i policisë së tiranës u takuan me gazetarin dhe i premtuan hetim të plotë. Deri në shtator, nuk kishte ndonjë raport për rezultatet e ndonjë hetimi.

Më 16 qershor, gjatë një operacioni të madh policie për të marrë kontrollin e fshatit jugor të Lazaratit, i njohur për kultivimin e kanabisit, persona të përfshirë në një betejë të armatosur me policinë sulmuan një automjet të televizionit A1 Report. Ata i detyruan gazetarin, kameramanin dhe shoferin të dilnin nga makina me armën drejtuar atyre dhe i mbajtën peng për disa minuta derisa një banor i zonës i shpëtoi. Automjeti u dogj pasi grupi i xhirimit i televizionit u nxor nga fshati.

Censurë ose Kufizime të Përmbajtjes: Gazetarët u ankuan se botuesit dhe redaktorët censuronin punën e tyre, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, si përgjigje ndaj presioneve politike dhe komerciale. Shumë gazetarë u ankuan se mungesa e kontratave të punësimit shpesh i pengonte të raportonin në mënyrë objective dhe i nxiste drejt autocensurës.

Në shtator, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë deklaroi që në 90 përqind të mediave të vendit, kishte vonesa prej dy deri katër muajsh në pagimin e pagave mujore të gazetarëve. Këto

vonesa bënin që disa gazetarë të mbështeteshin më fort tek burimet e jashtme të të ardhurave, çka ndikonte raportimin e tyre.

Ligje për Shpifjen/Siguria Kombëtare: Ligji siguron mbrojtje të posaçme për zyrtarët kombëtarë dhe të huaj të qeverisë ndaj padive për shpifje por lejon palët private që të ngrenë padi penale dhe të marrin kompensim financiar për ofendime ose botim të qëllimshëm të informacionit ofendues. OJQtë raportuan se gjobat, deri në tre milionë lekë ($29,200) ishin të ekzagjeruara dhe së bashku me futjen e një dënimi në historikun penal të të padituri shkelnin të drejtën për lirinë e shprehjes.

Në vitin 2012, Gjykata e Rrethit e Tiranës gjobiti transmetuesin Top Channel me 51 milionë lekë ($497,000) për transmetimin në vitin 2009 të filmimeve me kamera të fshehtë që çuan në shkarkimin e ish ministrit të kulturës, rinisë dhe sporteve Ylli Pango. Gjykata e Apelit e ktheu çështjen në gjykatën e rrethit. Gjykata e rrethit vendosi kundër Pangos, i cili e apeloi përsëri vendimin. Deri në shtator, gjykata e apelit nuk e kishte shqyrtuar çështjen.

Liria e Internetit

Qeveria nuk kufizoi apo ndërpreu akses në internet dhe as nuk censuroi përmbajtje online dhe nuk pati raporte të besueshme se qeveria monitoronte komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor. Sipas të dhënave të hartuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, afërsisht 60 përqind e popullsisë e përdori internetin në vitin 2013. Rreth 35 përqind ishte pajtuar në internet me bandë të gjerë të lëvizshme ndërsa 5.8 përqind ishin pajtuar në internet me bandë të gjerë fikse. Banda e gjerë fikse ishte e përqendruar më së shumti në zonat urbane.

Liria Akademike dhe Aktivitetet Kulturore

Nuk pati kufizime nga qeveria të lirisë akademike apo aktiviteteve kulturore.

b. Liria e Grumbullimit Paqësor dhe Shoqatave

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e grumbullimit dhe shoqatave, dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta.

c. Liria e Fesë

Shih *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë Fetare* të Departamentit të Shtetit në www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

d. Liria e Lëvizjes, Personat e Zhvendosur Brenda, Mbrojtja e Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimit jashtë vendit, emigrimit dhe riatdhesimit dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta. Hera-herës

qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ofruar mbrojtje dhe ndihmë për refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, personat pa nënshtetësi, si dhe persona të tjerë, edhe pse policia refuzoi të lejonte UNHCR që të monitoronte përpunimin, ndalimin dhe deportimin e disa migrantëve.

Lëvizjet Brenda Vendit: Individët që lëvizin brenda vendit duhet të transferojnë regjistrimin e tyre civil në komunitetin e ri të banimit me qëllim që të përfitojnë shërbimet qeveritare dhe të vërtetojnë se janë banorë të ligjshëm me anë të zotërimit të pronës, marrëveshjes së një qeraje për prone, ose faturat e shërbimeve utilitare. Shumë persona nuk mund ta siguronin këtë provë dhe për pasojë iu mungonte aksesi në shërbimet publike. Të tjerë shtetasve iu mungonte regjistrimi formal në komunitetet ku banonin, sidomos romëve dhe ballkano-egjiptianëve. Ligji nuk ndalon regjistrimin e tyre, por shpesh ishte e vështirë të përmbushej. Qeveria shkurtoi disa kërkesa për regjistrim gjatë vitit për të ulur barrën mbi popullatat e margjinalizuara, të tillë si romët dhe ballkano-egjiptianët.

Mbrojtja e Refugjatëve

Aksesi në Azil: Ligji siguron akordimin e azilit ose statusit të refugjatit dhe qeveria ka ngritur një sistem për të ofruar mbrojtje për refugjatët. Pati raportime të besueshme se autoritetet nuk ndoqën detyrimet për proces të rregullt ligjor për disa azilkërkues. Në shtator, parlamenti miratoi një ligj të ri për azilin, në përpjekje për të përafruar më ngushtë ligjin vendas me standardet ligjore të BE. UNHCR e kritikoi ligjin për përfshirjen e një dispozite për sigurinë kombëtare, i cili e lejon qeverinë të kthejë azilkërkues kur individi paraqet kërcënim për sigurinë ose ka qenë më parë i dënuar për krime që ndëshkohen me të paktën shtatë vite burg. Ligji për azilin kërkon që autoritetet të akordojnë ose mohojnë azilin brenda 51 ditëve nga kërkesa fillestare e kërkuesit. Azilkërkuesit nuk përballen me akuza të hyrjes së paligjshme nëse ata kontaktojnë me autoritetet brenda 10 ditësh nga mbërritja e tyre në vend. Policia citoi një ligj mbi të huajt si baza për deportimin e migrantëve që nuk kërkonin azil brenda 10 ditësh nga hyrja në vend. UNHCR raportoi se sistemi i azilit nuk kishte një mekanizëm efektiv monitorimi dhe si rezultat emgrantët e parregullt nuk patën mundësi të ushtronin të drejtën e tyre për të apeluar urdhërat e policisë për deportim. UNHCR raportoi se për shkak të burimeve të pakta, mungesës së përkthyesve të përshtatshëm, dhe arsye të tjera, performanca e policisë në sistemin e parakontrollit pati rënie.

Vend i Sigurtë Origjine/Tranziti: Ligji ua ndalon individëve nga vende të sigurta origjine që të aplikojnë për azil ose status refugjati.

Përfitimi i Shërbimeve Bazë: Ligji u siguron regugjatëve përfitim nga shërbimet publike, përfshirë arsimim, kujdes shëndetësor, strehim, zbatim ligji, procedura gjyqësore, dhe asistencë ligjore. Refugjatët shpesh kërkojnë ndërhyrjen e UNHCR ose organizatave jo-qeveritare lokale për të përfituar këto shërbime.

Zgjidhje të Qëndrueshme: Qeveria vazhdoi të mundësonte integrimin në vend të refugjatëve Mujahedin-e Khalq nga Iraku gjatë vitit të kaluar. Qeveria lehtësoi kthimin e sigurtë vullnetar të dy refugjatëve.

Mbrojtja e Përkohshme: Qeveria gjithashtu siguroi mbrojtje të përkohshme për individë që mund të mos kualifikohen si refugjatë dhe deri në shtator e bëri këtë për katër persona.

Personat Pa Nënshtetësi

Në vitin 2011 UNHCR raportoi se kishte 7,443 persona pa nënshtetësi në vend. Sipas UNHCR, shumica e personave pa nënshtetësi ishin fëmijë romë. Arsyet për mungesën e nënshtetësisë përfshinin emigrimin ndërkufitar dhe mosregjistrimin e fëmijëve në lindje nga prindërit. Qeveria bëri përpjekje për përmirësimin e regjistrimit të fëmijëve të lindur në spitale dhe udhëzoi ambasadat e saj në vendet fqinjë të ndihmonin me regjistrimin e tyre jashtë vendit.

Seksioni 3. Respektimi i të Drejtave Politike: E drejta e Qytetarëve për të Ndryshuar Qeverinë e Tyre

Kushtetuta u siguron qytetarëve mundësinë për të ndryshuar qeverinë e tyre nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të drejta, të cilën ata e ushtrojnë nëpërmjet zgjedhjeve që bazohen tek e drejta universale e votës.

Zgjedhjet dhe Pjesëmarrja Politike

Zgjedhjet e fundit: Në qershor 2013 vendi mbajti zgjedhje parlamentare të cilat misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR raportoi të ishin "konkuruese me pjesëmarrje aktive të qytetarëve gjatë gjithë fushatës dhe respekt të vërtetë për liritë themelore". Sidoqoftë, OSBE gjithashtu vuri në dukje se "atmosfera e mosbesimit midis dy partive kryesore politike njollosi mjedisin elektoral dhe vështirësoi administrimin e të gjithë procesit zgjedhor". Misioni i vëzhgimit gjithashtu citoi problemet me parregullsitë proceduriale dhe rastet e mbivendosjes së papërshtatshme midis institucioneve shtetërore dhe interesave partiake.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) veproi pa një kuorum gjatë gjithë zgjedhjeve për shkak të bojkotimit nga pala opozitare pas pushimit nga kryeministri të njërit prej anëtarëve. OSBE raportoi se shumë persona krijuan përshtypjen se KQZ veproi në mënyrë partiake, gjë e cila kontribuoi në ndjenjë të përgjithshme mosbesimi nga publiku.

Pjesëmarrja e Grave dhe Minoriteteve: Ligji kërkon që gratë të zënë 30 përqind të posteve me emërim dhe zgjedhje, dhe kodi elektoral kërkon që 30 përqind e kandidatëve të jenë gra. Jo të gjitha partitë e zbatuan kodin elektoral; gjobat për mospërmbushje ishin të ulëta. Në vitin 2013 KQZ gjobiti Partinë Demokratike, Partinë Socialiste, dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim për mospërmbushjen e detyrimit ligjor për kuota në listën e tyre të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të 2013. Organizatat jo-qeveritare kritikuan partitë politike për mosemërimin e më shumë grave në Parlament nga listat

shumëemërore të partive, në veçanti në rastet kur vende të Parlamentit u bënë vakante, pavarësisht ligjeve të shkruara për të nxitur emërimin e grave. Gratë vazhduan të kishin përfaqësim të ulët në poste publike, përfshirë në parlament. Në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2013, 25 gra morën mandate në Kuvendin prej 140 deputetësh, një rritje me 22 vende krahasuar me parlamentin e mëparshëm. Numri i ministreve në qeverinë e re u rrit në gjashtë, krahasuar me një në qeverinë e mëparshme. Deri në shtator pati 29 deputete dhe shtatë ministre.

Kërkesat për regjistrim në zyrën civile dhe mungesa e identifikimit e bënë të vështirë pjesëmarrjen e romëve në zgjedhjet e qershorit 2013. Media publikoi raporte për përpjekje për të konfiskuar dokumenta identifikimi të votuesve romë në shkëmbim të parave ose ushqimit para zgjedhjeve. Deri në tetor nuk pati ministra ose deputetë romë. Disa anëtarë të minoritetit grek nga parti të ndryshme politike u zgjodhën në parlament, dhe një anëtar i mirënjohur i partisë që përfaqëson minoritetin grek u bë nënkryetar parlamenti.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe Mungesa e Transparencës në Qeverisje

Ligji siguron ndëshkime penale për korrupsion nga zyrtarët, dhe gjatë vitit parlamenti prezantoi ndëshkime më të rrepta si pjesë e përpjekjeve më të gjera anti-korrupsion të qeverisë. Qeveria nuk zbatoi ligjin me efektivitet dhe zyrtarët shpesh u angazhuan në praktika korruptive pa u ndëshkuar.

Korrupsioni: Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha degët e qeverisjes. Nga janari deri në qershor, njësitë e përbashkëta hetimore, njësi shumëpalëshe që hetojnë dhe çojnë për ndjekje penale krime financiare dhe të korrupsionit në sektorin publik, nisën 762 hetime të reja dhe çuan në gjykatë 131 çështje. Gjykimet mbi 129 çështje përfunduan duke rezultuar me vendim fajësie për 183 të paditur dhe pushim çështjeje për 26 të tjerë. Deri në qershor procedurat gjyqësore për 289 të pandehur vazhdonin.

Në dhjetor 2013, në një konferencë për shtyp transmetuar në televizion,ministrja e mbrojtjes njoftoi për ngritjen e akuzave për korrupsion gjatë një tenderi për reklama televizive kundër ish-ministrit të mbrojtjes Arben Imami nga partia opozitare. Më vonë prokurorët e pushuan çështjen, sipas tyre për shkak të mungesës së provave. Të tjera akuza të ngritura kundër ish-ministrit ishin ende pezull në muajin shtator.

Gjatë vitit prokurorët çuan për gjykim kryegjykatësin e rrethit gjyqësor të Pukës, kryeprokurorin e rrethit, kryekancelaren, kryesekretaren, dy individë privatë dhe një avokat mbrojtës për një numër akuzash lidhur me korrupsion aktiv, abuzim me detyrën, mundësim i korrupsionit, dhe moskallëzim krimi. Një gjykatë shpalli fajtore kryekancelaren, kryesekretaren, dy qytetarët dhe avokatin mbrojtës. Në muajin shtator çështja kundër kryegjykatësit dhe kryeprokurorit të rrethit vazhdonte ende.

Në nëntor 2013 qeveria ia ngarkoi koordinimin e plotë të veprimeve antikorrupsion Koordinatorit Kombëtar për Antikorrupsion, një zyrë e krijuar rishtazi për mbikqyrjen e një rrjeti pikash qendrore antikorrupsioni në ministritë e linjës, në institucione të pavarura

dhe në nivel lokal. Një njësi e ristrukturuar për Kontrollin e Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionin u përqendrua vetëm mbi kontrollin e brendshëm administrativ.

Korrupsioni ishte problem në radhët e policisë, dhe autoritetet ndërmorën masa për ta luftuar atë. Megjithëse Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në qeveri hetoi dhe raportoi për ndjekje penale një numër oficerësh policisë mjaft më të lartë se në 2013 gjykatat shpallën fajtorë vetëm pak prej tyre.

Qeveria bëri përpjekje për t'u marrë me raportimet e përhapura se policia në disa raste kishte pranuar rryshfete në shkëmbim të mosvënies së gjobave ose mospërfshirjes së informacionit personal në bazat e të dhënave kriminale. Policia instaloi sisteme kamerash në makinat e patrullave të policisë dhe oficerët refuzuan më shpesh rryshfetet, për shkak të mbikqyrjes së shtuar. Qeveria gjithashtu kreu një fushatë të ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit. Zbatimi i një sistemi automatik të menaxhimit të gjobave të qarkullimit gjithashtu pakësoi mundësitë e praktikave korruptive nga policia e trafikut.

Seksioni i Policisë së Shtetit kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit hetoi raste korrupsioni. Seksioni kishte kapacitete të kufizuara për hetimet dhe mbikqyrjen sekrete, duke penguar kështu hetimet. Edhe agjenci të tjera, përfshirë autoritetet tatimore dhe doganore dhe kontrollorët dhe rregullatorët shtetërorë kryen hetime anti-korrupsioni. Rrjedhja e informacionit rreth hetimeve, presioni politik real dhe i perceptuar, si dhe një sistem kaotik riemërimi, penguan përpjekjet e tyre si dhe ato të Policisë së Shtetit. Komisioni Europian raportoi se Policia e Shtetit rriti numrin e çështjeve të korrupsionit që i referoi për ndjekje midis muajit tetor 2013 dhe mars 2014 me 16 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012-2013.

Korrupsioni mbeti gjithashtu një problem në institucionet arsimore, përfshirë në universitetet publike. Shumë studentë u ankuan që mësuesit kërkuan rryshfete për të kaluar klasën, duke e bërë të vështirë për disa prej tyre që të vazhdonin studime të mëtejshme.

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, duke punuar nëpërmjet njësive hetimore të përbashkëta, u mor me ndjekje penale. Kishte tetë njësi në qytetet më të mëdha të vendit. Ato bënë përparime domethënëse në ndjekjen e çështjeve korruptive të profilit të ulët, por ndjekja penale e krimeve të nivelit të lartë mbeti e e papërfillshme për shkak të frikës së hetuesve për ndëshkim, mungesës së përgjithshme të burimeve dhe korrupsionit në gjyqësor. Gjatë vitit qeveria rriti numrin e prokurorëve antikorrupsion në zyrat rajonale të prokurorisë. Komisioni Europian raportoi se dënimet u rritën me 8 përqind në gjykatat e rretheve, ndërsa dënimet në gjykatat e apelit u rritën me 8 përqind në periudhën tetor 2013-mars 2014, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2012-2013.

Në qershor përgjegjësia për raste korrupsioni që përfshijnë zyrtarë qeverisës të nivelit të lartë, si dhe gjykatës, prokurorë, zyrtarë të gjyqësorit dhe përfaqësues të zgjedhur vendor iu transferua Zyrës së Prokurorit të Krimeve të Rënda dhe gjykatave të krimeve të rënda.

Agjencitë ligjzbatuese të antikorrupsionit nuk bashkëpunuan aktivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme me shoqërinë civile në shumë raste por bashkëpunuan në raste të caktuara që aktorët ndërkombëtarë i sollën në vëmendjen e tyre, shumë herë me kërkesën e shoqërisë civile. Ato patën burime të pamjaftueshme.

Deklaratat Financiare: Ligji u kërkon zyrtarëve publikë që të deklarojnë pasuritë e tyre pranë Inspektoriatit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit (HIDAACI), e cila monitoroi dhe verifikoi këto deklarata. HIDAACI i bëri publike këto deklarime. Gjatë vitit u miratuan dispozita ligjore me qëllim rritjen e fuqive investigative të Inspektoriatit për hetimin e deklaratave të pasurisë dhe konflikteve të interesit. Dispozitat forcuan kapacitetet e institucionit dhe rritën transparencën publike. Ligji autorizon Inspektoriatin të vendosë gjoba për zyrtarët që nuk përmbushin kërkesat për deklarim ose t'i referojë ata pranë prokurorisë. Deri në gusht Inspektoriati gjobiti 175 individë për vonesa në deklarimet e tyre dhe për konflikte interesi. Sipas Inspektoriatit, deri në gusht ishin referuar për ndjekje penale 47 raste përfshirë zyrtarë të lartë publikë si ambasadorë dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjykatës të tjerë, prokurorë, asistentë juridikë të presidentit, punonjës të tatimeve dhe doganave, dhe zyrtarë të qeverisë lokale.

E Drejta e Informimit Publik: Ligji siguron të drejtën e informimit nga institucionet qeverisëse por qeveria nuk e zbatoi me efektivitet ligjin. Procesi për bërjen publike të informacionit shpesh nuk ishte i qartë, dhe zyrtarët në disa raste hezituan të lëshonin informacion. Ligji përcakton që e drejta për marrjen e informacionit mund të kufizohet kur informacioni është përcaktuar si i klasifikuar ose kur dhënia e një informacioni do të shkel mbrojtjen e të dhënave personale.

Në shtator u miratua një ligj i ri për të drejtën e informimit. Ai siguron afate më të shkurtra për dhënien e informacionit si dhe për emërimin e një komisionieri të të drejtës së informimit me fuqinë për të gjobitur insitucionet që nuk e zbatojnë ligjin dhe për caktimin e oficerëve të informacionit në të gjitha agjencitë shtetërore përgjegjëse për kërkesat për informacion. Shumica e ministrive dhe agjencive qeveritare publikuan informacione drejtpërsëdrejti në faqet e tyre në internet. Bizneset dhe qytetarët u ankuan që procesi nuk ishte transparent dhe se autoritetet nuk publikuan disa rregullore dhe ligje që duhet të ishin informacion publik themelor. Qytetarët shpesh u përballën me probleme serioze në marrjen e informacionit të tillë. Individët në përgjithësi mund të merrnin informacion nga qeveria pa pagesë, por pati raste të veçanta në të cilat tarifa përpunimi u kërkuan për të mbuluar kostot e shërbimit për institucionin që jepte informacionin. Moszbatimi ndëshkohet si shkelje administrative, jo penale. Qytetarët mund të apelojnë mohimin e bërjes publike pranë autoritetit ku është bërë kërkesa fillimisht ose pranë një gjykate civile.

Seksioni 5. Qëndrimi i Qeverisë në Lidhje me Hetimet Ndërkombëtare dhe Joqeveritare të Dyshimeve për Dhunim të të Drejtave të Njeriut

Disa grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizime nga qeveria, me hetime dhe publikime të gjetjeve të tyre në lidhje me çështje të

të drejtave të njeriut. Zyrtarë të qeverisë në përgjithësi bashkëpunuan dhe iu përgjigjën këndvështrimeve të tyre.

Organe qeveritare të të drejtave të njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor i të drejtave të njeriut për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit ka autoritetin të kontrollojë mjediset e paraburgimit dhe burgjet. Ai mund të hapë një hetim në disa raste ku nuk ka një viktimë që mund ta bëjë këtë. Edhe pse Avokatit të Popullit i mungonte pushteti për të zbatuar vendime, ai veproi si monitorues i shkeljeve të të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit raporton në kuvend çdo vit. Ndërkohë që kuvendi shpërndau kopje të disa prej raporteve të posaçme të Avokatit të Popullit apo i publikoi ato në internet, në përgjithësi nuk i diskutoi zyrtarisht raportet në seancat plenare apo të komisioneve. Kuvendi u konsultua me Zyrën e Avokatit të Popullit në çastet e fundit për projektligje që ndikonin drejtëpërsëdrejti këtë institucion. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ishte i financuar mjaftueshëm.

Kuvendi ka një komision për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut. Kuvendi miratoi disa ligje që synonin trajtimin e problemeve të të drejtave të njeriut, përfshirë një ligj për të burgosurit, për personat e persekutuar gjatë ish-regjimit komunist dhe personave me aftësi të kufizuara; megjithatë, Avokati i Popullit dhe disa OJQ kritikuan disa aspekte të këtyre ligjeve.

Rastet e diskriminimit mund të sillen përpara komisionerit të qeverisë për çështjet kundër diskriminimit që ka autoritetin të vendosë sanksione. Deri në shtator komisioneri mori 77 ankesa për diskriminim, krahasuar me 60 gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2013. Komisioneri nxori 14 vendime kundër diskriminimit dhe ngarkoi sanksione në dy çështje. Ligji e lejon komisionerin kundër diskriminimit të dëshmojë si dëshmitar ekspert edhe në apelime të çështjeve që ka refuzuar zyra. Deri në shtator gjykatat gjykuan dy çështje që vinin në provë zbatimin e ligjit. Në të dyja çështjet, gjykata vendosi se kishte ndodhur diskriminim në vendin e punës.

Seksioni 6. Diskriminimi, Abuzimet Shoqërore dhe Trafikimi i Personave

Ligji ndalon diskriminimin në bazë race, gjinie, moshe, paaftësie, gjuhe, besimi fetar, identiteti gjinor dhe/ose orientimi seksual, statusi shëndetësor, familjar, ekonomik apo social. Qeveria nuk i zbatoi si duhet këto ndalime.

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi, përfshirë atë nga bashkëshorti, është krim, por qeveria nuk e zbatoi si duhet këtë ligj. Viktimat raportuan rrallë abuzimin nga bashkëshorti dhe zyrtarët nuk ndoqën penalisht përdhunimin nga bashkëshorti. Koncepti i përdhunimit nga bashkëshorti nuk ishte përcaktuar mirë dhe shpesh autoritetet dhe publiku nuk e konsideronin atë si krim. Dënimet për përdhunimin dhe sulmin ndaj personit janë në varësi të moshës së viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri parashikohet dënim me burg nga tre deri në 10 vjet; për përdhunim adoleshenti nga mosha 14 deri në 18 vjeç dënimi shkon nga pesë deri në 15 vjet dhe për përdhunimin e

një të mituri nën 14 vjeç dënimi është nga shtatë deri në 15 vjet. Kodi penal përfshin dispozita për sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe shprehet qartë për kriminalizimin e përdhunimit nga bashkëshorti.

Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin nga bashkëshorti mbeti një problem serioz. Deri në qershor, policia mori ankesa për 1.876 raste dhune në familje nëpërmjet linjës së tyre telefonike të urgjencës, krahasuar me 3.020 raste gjatë gjithë vitit 2013. Policia u referoi prokurorëve 649 çështje deri në qershor, krahasuar me 428 referuar prokurorëve gjatë gjithë vitit 2013. Prokurorët dërguan në gjykatë 400 çështje kundër 421 të pandehurve deri në qershor, krahasuar me 589 çështje të dërguara për gjykim kundër 606 të pandehurve gjatë gjithë vitit 2013. Gjykatat nxorën 1.306 urdhra kufizimi deri në tetor të vitit 2013, krahasuar me 1.146 urdhra të nxjerrë gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2012. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin e duhur për t'u marrë në mënyrë efikase me rastet e dhunës në familje.

Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale merret me çështjet e grave, përfshirë dhunën në familje. Streha qeveritare për viktimat e dhunës në familje në Tiranë ndihmoi 21 gra dhe 36 fëmijë deri në gusht, por nuk mund të pranonte viktima pa urdhër gjykate. OJQ-të patën nën kontroll katër strehëza për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje, dy në Tiranë dhe dy jashtë kryeqytetit.

Gjymtimi gjenital i femrave: Ligji nuk ndalon në mënyrë të qartë gjymtimin gjenital të femrave, ndonëse e mbulon nën ligjet për dëmtime të përgjithme. Nuk pati raportime të gjymtimit gjenital të femrave.

Ngacmimi seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual; megjithatë, zyrtarët rrallë e zbatuan ligjin. OJQ-të besojnë se ngacmimi seksual mbeti tejet i pa raportuar.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin të lirisht dhe me përgjegjësinë e tyre numrin e fëmijëve, distancën kohore mes fëmijëve dhe kohën kur do të kenë fëmijë dhe kanë të drejtë të kenë informacionin dhe mjetet për ta bërë këtë. Ata kanë të drejtën të marrin nivelin më të lartë të kujdesit riprodhues shëndetësor, të lirë nga diskriminimi, detyrimi apo dhuna. Sipas ligjit u jepet kujdes shëndetësor të gjithë shtetasve. Megjithatë, cilësia dhe marrja e kujdesit shëndetësor, përfshirë atë obstetrik dhe pas lindjes, nuk ka qenë i kënaqshëm, veçanërisht në zonat rurale. Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor, vetëm 11 për qind e popullsisë përdorte metoda kontraceptive moderne. Për të trajtuar këto probleme, Ministria e Shëndetësisë zbatoi një strategji të planifikimit familjar me ndihmën e Fondit të Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA) për periudhën 2012-2016. Strategjia synonte të rriste kërkesën dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve cilësore për kujdesin e shëndetit riprodhues dhe të shërbimeve të planifikimit familjar nëpërmjet rritjes së përdorimit të kontraceptivëve, uljes së numrit të shtatzanive të padëshiruara dhe të përmirësimit të shëndetit të nënës dhe foshnjes.

Diskriminimi: Ligji siguron të drejta të barabarta për burrat dhe gratë bazuar në ligjin e familjes, ligjin e pronës dhe në sistemin gjyqësor. Gratë nuk u përjashtuan nga profesione

të caktuara as me ligj e as në praktikë, por ishin të nënpërfaqësuara në nivelet më të larta në fushat e tyre. Edhe pse ligji përcakton pagë të barabartë për punë të barabartë, qeveria dhe punëdhënësit privatë nuk e zbatuan tërësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë ishin objekt i diskriminimit social si rezultat i normave sociale tradicionale që i konsideronin gratë nën varësinë e burrave (shikoni seksionin 7.d.). Në qershor qeveria nisi reformat për programin e mirëqenies sociale në mënyrë që pagesat mujore të asistencës sociale për familjet t'u paguheshin vetëm grave, në vend të kryefamiljarëve, që tradicionalisht kanë qenë burra.

Përzgjedhja e seksit mbi bazë gjinore: Sipas agjencisë qeveritare të statistikave, raporti mes djemve dhe vajzave të lindur në vitin 2013 ishte 109 me 100, që tregon se mund të ketë përzgjedhje të seksit mbi bazë gjinore. Qeveria nuk i mbështeti përpjekjet për të trajtuar mungesën e ekulibrit në raportin e lindjeve mes meshkujve dhe femrave në vend.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Nënshtetësia vjen automatikisht me lindjen brenda territorit të vendit ose si trashëgimi nga njëri prind që është nënshtetas. Prindërit inkurajohen të regjistrojnë lindjen e fëmijës së tyre brenda afateve kohore. Për të nxitur regjistrimin e hershëm, ligji jep një shpërblim monetar për prindërit që i regjistrojnë fëmijët e tyre deri në 60 ditë pas lindjes. Megjithatë, shpesh autoritet nuk e paguan shpërblimin. Nuk pati raportime diskriminimi në regjistrimin e lindjes, por kërkesat për vendbanim në regjistrim e vështirësuan regjistrimin e shumë fëmijëve për prindërit nga komuniteti rom dhe egjiptiano-ballkanik pa vendbanim të dokumentuar ligjërisht dhe aksesin e tyre ndaj disa shërbimeve qeveritare që vareshin nga regjistrimi.

Sipas OJQ-së vendase Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), fëmijët e lindur nga migrues të brendshëm apo ata që janë kthyer nga jashtë shtetit shpesh nuk kishin certifikata lindjeje apo dokumente të tjera ligjore dhe si rrjedhojë nuk mundën të ndiqnin shkollën. Ky problem hasej veçanërisht në familjet rome në të cilat çiftet shpesh martoheshin në moshë të re dhe nuk regjistronin lindjen e fëmijëve të tyre.

Arsimi: Ligji parashikon arsim falas për nëntë vjet dhe autorizon shkollat private. Ndjekja e shkollës është e detyruar deri në klasën e nëntë ose në moshën 16 vjeç, cilado vjen më herët, por shumë fëmijë e lanë shkollën më parë për të punuar për familjet e tyre, veçanërisht në zonat rurale. Prindërit duhet të blejnë mjetet, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klasa, të cilat kushtojnë tej mase për shumë familje, veçanërisht për romët dhe pakica të tjera. Shumë familje u shprehën gjithashtu se këto shpenzime ishin shkaku se pse nuk i dërgonin vajzat në shkollë. Megjithëse qeveria ka program për rimbursimin e kostos së blerjes së librave shkollorë për familjet me të ardhura të ulëta, shumë familje dhe OJQ raportuan se nuk ishin në gjendje të merrnin rimbursimin pasi kishin blerë librat.

Abuzimi me fëmijët: Kanë ndodhur abuzime me fëmijët, përfshirë abuzimin seksual, edhe pse viktimat rrallë e raportuan këtë. Sipas një raporti të Fondit të Kombeve të

Bashkuara për Fëmijët në vitin 2013, 57 për qind e fëmijëve të vendit, midis moshave dy dhe 14 ishin subjekt i dhunës psikologjike dhe/ose fizike. CRCA raportoi në vitin 2013 se 58 për qind e fëmijëve ishin viktima të abuzimit fizik, 11 për qind e fëmijëve ishin viktima të ngacmimit seksual dhe thuajse 5 për qind e fëmijëve raportuan se kishin qenë viktima të abuzimit seksual. Pothuajse 70 për qind e fëmijëve raportuan abuzim psikologjik nga anëtarë të familjes, sipas CRCA.

Martesa e hershme dhe me detyrim: Ndonëse mosha e lejuar ligjërisht për martesë është 18 vjeç, autoritet nuk e zbatuan ligjin. Martesat nën moshë ndodhnin kryesisht në zonat rurale dhe brenda komuniteteve rome. Sipas statistikave të UNFPA të vitit 2009, 9,6 për qind e femrave nga mosha 20 deri në 24 ishin martuar pa mbushur moshën 18 vjeç. UNFPA raportoi se në vitin 2011, rreth 31 për qind e vajzave nga 13 deri në 17 vjeç nga komuniteti rom ishin të martuara. Disa OJQ raportuan se martesat e hershme dhe të detyruara kishin ndodhur në komunitete rurale si pjesë e skemave të trafikimit njerëzor, kur prindërit pranonin që vajzat e tyre nën moshë të martoheshin me burra të huaj më të mëdhenj në moshë, të cilët më pas i trafikonin ato në vende të tjera.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Disa fëmijë nën moshën 18 vjeç u shfrytëzuan për prostitucion. Dënimet për shfrytëzim seksual të fëmijëve për përfitim variojnë nga tetë deri në 15 vjet heqje lirie. Vendi ka ligj për përdhunimin e moshës së mitur dhe mosha e lejueshme për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi për dhunim seksual të fëmijës nën moshën 14 vjeç është heqje lirie nga pesë deri në 15 vjet. Në rrethana rënduese dënimi mund të rritet deri në burgim të përjetshëm. Ligji ndalon bërjen dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë me burg nga tre deri në 10 vjet. Zotërimi i pornografisë me fëmijë është i ndaluar. Në vitin 2013 kuvendi miratoi ndëshkime më të rënda për krimet kundër të miturve, përfshirë abuzimin seksual; ngacmimin seksual; shfrytëzimin për qëllim prostitucioni; përfitimi prej shërbimeve të ofruara nga persona të trafikuar, përfshirë të mitur; lehtësimi i trafikimit, përfshirë të të miturve; dhe dhunën në familje. Në përgjithësi, autoritetet zbatuan me efikasitet ligjet në lidhje me përdhunimin dhe shfrytësimin seksual të të miturve, por OJQ-të raportuan se ligjet për pornografi me fëmijë rrallë u zbatuan. Të dhënat e policisë për vitet 2012 dhe 2013 treguan se 708 fëmijë ishin viktima të krimit, nga të cilët 58 përjetuan dhunë brenda familjes dhe 22 përjetuan shfrytëzim seksual.

Fëmijët e zhvendosur: Vazhdoi të kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë të rrugës, veçanërisht brenda komunitetit rom. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla; disa migruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë ishin më të ekspozuarit ndaj rrezikut të trafikimit, dhe disa prej tyre u bënë viktima trafikimi. Disa fëmijë të zhvendosur u përdorën nga bandat kriminale për të vjedhur shtëpi sepse ligji ndalon ndjekjen penale të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për vjedhje. U hetuan shumë pak raste trafikimi fëmijësh (shikoni seksionin 7.d).

Në maj, në bashkëpunim me OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare, qeveria botoi raportin e parë të vendit për fëmijët e rrugës. Sipas raportit, më shumë se 2.500 fëmijë ose lypnin ose punonin në mënyrë informale në rrugë, rreth 75 për qind e të cilëve ishin nga komunitetet rome ose egjiptiano-ballkanike. Studimi gjeti se pjesa më e madhe e

fëmijëve të rrugës jetonin në një shtëpi me të dy prindërit. Fëmijët më së shpeshti raportuan se fitimi i parave për familjet e tyre ishte arsyeja kryesore për lypjet ose punën e tyre, ndërsa një e treta e këtyrë fëmijëve tha se prindërit i detyronin të punonin. Sipas raportit, një e treta e fëmijëve të rrugës rrezikonin të trafikoheshin. Në përgjigje të studimit, qeveria zbatoi një program pilot në Tiranë për të larguar fëmijët nga rruga dhe për t'iu dhënë atyre kujdes social. Qeveria nisi gjithashtu ofrimin e stimujve për prindërit që të dërgonin fëmijët e tyre në shkollë dhe që t'i vaksinonin ata.
Raporti për fëmijët e rrugës theksoi gjithashtu një fenomen të ri, shfrytëzimin e raportuar të më shumë se 300 fëmijëve për të korrur kanabis në fushat e bashkisë jugore të Lazaratit.

Fëmijët në institucione përkujdesjeje: Pati raportime që jetimët e larguar nga kujdestaria e shtetit në moshë të rritur përballeshin me sfida të mëdha për të gjetur strehim dhe shërbime të përshtatshme.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi është palë në Konventën e Hagës të vitit 1980-të mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Për informacion të mëtejshëm shikoni raportin e Departamentit të Shtetit në faqen e internetit: travel.state.gov/content/childabduction/english/country/Albania.html.

Antisemitizmi

U raportua se në vend kishte vetëm disa qindra hebrenj. Nuk pati raportime për akte antisemitizmi**.**

Trafikimi i personave

Shikoni *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në faqen e internetit: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsimim, transport, mundësi shfrytëzimi të kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtetërore. Pavarësisht këtyre ndalimeve ligjore, punëdhënësit, shkollat, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të tjera shtetërore në disa raste u përfshinë në diskriminim të personave me aftësi të kufizuara. Ligji urdhëron që ndërtesat e reja publike të kenë mundësi shfrytëzimi nga personat me aftësi të kufizuara, por qeveria e zbatoi këtë ligj vetëm në mënyrë sporadike. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 24 për qind e personave me aftësi të kufizuara nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën dhe 65 për qind e këtyre ishin femra. Varfëria e përhapur, kushtet e parregulluara të punës dhe kujdesi i dobët mjekësor përbënin probleme të rënda për shumë persona me aftësi të kufizuara. (shikoni seksionin 7.d.).

Personat me aftësi të kufizuara nuk u penguan të merrnin pjesë në çështje qytetare, megjithëse kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e vështirësuan pjesëmarrjen e tyre të plotë në shumë aktivitete. Qeveria ngriti agjenci për shërbime sociale në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, por këto agjenci shpesh nuk patën fonde për zbatimin e programeve të tyre. Ligji nuk kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë; megjithatë qendrat e votimit shpesh ishin vendosur në mjedise me mungesë akomodimesh për persona të tillë. Raporti i Misionit të OSBE/ODIHR-it raportoi se gjatë zgjedhjeve të qershorit 2013, rreth 44 për qind e qendrave të votimit ishin të pamundura për t'u arritur prej votuesve me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit inspektoi rregullisht institucionet e shëndetit mendor. Pranimi dhe nxjerrja e pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishte problem për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të dhënë vlerësime të sakta psikiatrike. Pati diskriminim dhe stigmatizim të personave me probleme të shëndetit mendor dhe forma të tjera të aftësive të kufizuara.

Në korrik kuvendi miratoi kornizën ligjore që zgjeroi kategoritë e personave me aftësi të kufizuara me të drejtën për të marrë ndihmë nga qeveria, për të përfshirë ata me autizëm, sindromën Down dhe aftësi të tjera të kufizuara më pak të njohura. Disa OJQ kritikuan ligjin sepse në vlerësimin e tyre do të tranferonte disa prej të drejtave nga organizatat e shoqërisë civile te qeveria.

Pakicat kombëtare/racore/etnike

Pati raportime për diskriminim të konsiderueshëm shoqëror kundër anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiano-ballkanike, përfshirë atë në lidhje me banesat, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Disa shkolla hezituan të pranonin nxënës romë dhe egjiptiano-ballkanikë, për më tepër kur këta ishin edhe të varfër. OJQ-të vendase raportuan se shumë shkolla që pranuan nxënës romë i linin ata mënjanë në klasa, me raste edhe duke i ndarë fizikisht nga pjesa tjetër e nxënësve.

Në muajt korrik dhe gusht, Komiteti i OKB për të Drejtat e Njeriut nxori dy vendime të përkohshme që i kërkonin qeverisë të mos përsëriste nxjerrjen në rrugë të disa familjeve romë që jetonin në Elbasan. Bashkia pati urdhëruar largimin e tyre që të përfundonte dy projekte të mëdha infrastrukture. Bashkia tërhoqi urdhrin e dëbimit dhe bëri një marrëveshje me tri familje për t'u subvencionuar atyre qeranë që ata të largoheshin në mënyrë vullnetare nga shtëpitë e tyre. Avokatët e të drejtave të njeriut shprehën shqetësime për kushtet e marrëveshjes. OJQ-të për të drejtat e romëve kritikuan gjithashtu mungesën e masave mbrojtëse ligjore kundër dëbimit dhe shkatërrimit të kampeve rome në një ligj të ri për legalizimin e pronës të miratuar në maj.

Ligji siguron status zyrtar pakice për grupet kombëtare dhe më vete për grupet etnike-gjuhësore. Qeveria përkufizon grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare ku grekët përbëjnë grupin më të madh. Ligji përkufizon arumunët (vllehët) dhe romët si grupe pakicash etnike-gjuhësore.

Pakica etnike greke u ankua për mungesën e vullnetit të qeverisë për të njohur qytete etnike greke jashtë "zonës së pakicës" përcaktuar nga regjimi komunist, për të përdorur gjuhën greke në dokumente zyrtare dhe tabela publike në zona etnike greke ose për të përfshirë një numër më të lartë grekësh etnikë në administratën publike. Në gjuhët rome, serbo-malazeze apo vllehe nuk ofrohej arsim publik.

Aktet e Dhunës, Diskriminimi dhe Abuzime të Tjera Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor

Ligji ndalon diskriminimin e individëve lezbikë, gei, biseksualë dhe transgjinorë (LGBT). Komisioneri i qeverisë kundër diskriminimit regjistroi disa ankesa nga individë dhe organizata LGBT. Komisioneri nxori sanksione kundër një pronari biznesi privat. Deri në gusht pronari i biznesit i kishte shpërfillur këto sanksione. Komisioneri i kërkoi gjykatës të detyronte dy politikanë të paguanin gjobat që iu ishin vendosur që prej vitit 2013 dhe që ata i patën shpërfillur. Zbatimi i ligjit në përgjithësi ishte i dobët (shikoni seksionin 7.d.).

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor ishin mes kategorive të mbrojtura nga ligji i vendit për krimet e urrejtjes. Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e grupit LGBT, qëndrimet homofobike vazhduan në jetën private dhe publike. Zyrtarë publikë disa herë bënë deklarata homofobike. Gjatë vitit, OJQ-të raportuan rritjen e numrit të familjeve që nxorën personat LGBT nga shtëpitë. Në mars një grua lesbike dhe foshnja e saj pesë muajshe u përzunë nga familja e saj pasi u zbulua orientimin e saj seksual. Në gusht tre persona rrahën një person transgjinor në një bar. Policia nuk mbërriti në kohë në skenën e krimit dhe nuk i gjeti autorët.

Më 17 maj aktivistët morën pjesë në një Pedalim Kundër Homofobisë, një xhiro e shkurtër me biçikleta në bulevardin kryesor të Tiranës, si dhe një panair diversiteti, ku që të dyja u mbajtën pa incidente, ndryshe nga vitet e mëparshme. Policia luajti rol të rëndësishëm për sigurimin e sigurisë së pjesëmarrësve gjatë aktiviteteve. Policisë së Tiranës iu dha trajnim për ndjeshmërinë nga OJQ LGBT dhe aktivistët i dhanë policisë çmimin "Aleat i vitit për LGBT".

Stigma Shoqërore për HIV dhe SIDA

Ligji ndalon diskriminimin e personave me HIV/SIDA. Ekziston një ndjenjë e përgjithshme stigme shoqërore kundër personave me HIV/SIDA edhe pse nuk pati raportime për dhunë kundër individëve të tillë gjatë vitit. Sipas raportit më të fundit të studimit demografik dhe të shëndetit (2008-2009), 71 për qind e grave dhe 69,3 për qind e burrave raportuan qëndrime diskriminuese kundër personave me HIV.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e Grupimit në Shoqata dhe e Drejta për Marrëveshje Kolektive

Ligji dhe rregulloret e statutet lidhur me të japin të drejtën që shumica e punonjësve të formojnë sindikata të pavarura, të kryejnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Qeveria i zbatoi këto ligje në mënyrë efikase. Ligji ndalon diskriminimin kundër sindikatave dhe siguron rikthimin e punonjësve të pushuar nga puna për shkak të aktivitetit me sindikatën. Ligji ndalon anëtarët e ushtrisë dhe zyrtarët e lartë të qeverisë të jenë pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë në mënyrë që të mund të regjistrohet. Ligji siguron të drejtën e grevës për të gjithë punonjësit me përjashtim të ushtarakëve në uniformë, policisë, personelit të domosdoshëm mjekësor dhe spitalor, personave që merren me kontrollin e trafikut ajror dhe shërbimeve të burgjeve, si edhe punonjësve të domosdoshëm ose jo të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ato elektrike. Punonjësit që nuk ishin pjesë e përjashtimit nga ky ligj ushtruan të drejtën e tyre për të bërë grevë. Ligji ndalon grevat që gjykohen nga gjykata të kenë natyrë politike. Këto ligje rrallë ofronin mbrojtje për punonjësit shtëpiakë apo migrantët. Transparency International raportoi se sindikatat e punëtorëve ishin të dobëta dhe se autoritet edhe kompanitë private ishin zakonisht kundër përpjekjeve të organizimit dhe të marrëveshjeve kolektive.

Zbatimi i këtyre ligjeve nga qeveria mbeti gjerësisht jo efikas. Burimet për të kryer inspektime dhe kompensim për shkeljet nuk ishin të mjaftueshme. Dënimet, përfshirë gjobat deri në pesëdhjetë fishin e pagës minimale, nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin subjekt i vonesave të gjata dhe apelimeve. Procedurat e arbitrazhit lejojnë vonesa domethënëse, të cilat kufizojnë mbrojtjen e punëtorëve kundër aktivitetit antisindikal.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen e të bëjnë marrëveshje kolektive dhe ligji përcakton procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve kolektive. Sindikatat që përfaqësojnë punonjës të sektorit publik kanë bërë marrëveshje drejtpërdrejt me qeverinë. Mbeti e vështirë arritja e marrëveshjeve të frytshme kolektive me punëdhënësit që ishin kundër organizimit dhe aktivitetit sindikal. Në këtë mjedis ishte e vështirë të viheshin në zbatim marrëveshjet e bëra.

b. Ndalimi i punës me forcë apo të detyruar

Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar apo me forcë; megjithatë qeveria nuk e zbatoi gjithmonë si duhet këtë ligj. Zbatimi u pengua për shkak të mungesës së bashkërendimit mes ministrive dhe zbatimit të parregullt të procedurave standarde të punës. Dënimet nga tetë deri në 15 vjet burgim qenë mjaftueshëm të rrepta për të frenuar shkeljet. Organizatat e zbatimit të ligjit ofruan trajnime për oficerët e tyre sipas qasjes anti-trafikim me viktimat në qendër të vëmendjes. Qeveria identifikoi një numër në rritje të viktimave të trafikimit, por ndoqi penalisht dhe dënoi një numër të vogël trafikuesish që nga prilli. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Antitrafikimit ishte efikase në ruajtjen e përpjekjeve të qeverisë kundër trafikimit.

Shqiptarët dhe filipinasit që punonin në vend ishin subjekt i punës me forcë gjatë vitit. Fëmijët ishin subjekt i lypjes me forcë dhe aktivitetit kriminial (shikoni seksionin 7.c.).

Shikoni gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* i Departamentit të Shtetit në faqen e internetit www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i Punës së të Miturve dhe Mosha Minimale për Punësim

Ligji përcakton moshën 16 vjeç si moshë minimale për punësim dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryejnë fëmijët nën moshën 18 vjeç. Fëmijët nga 16 deri në 18 vjeç mund të punojnë në disa punë të përcaktuara. Sipas ligjit, Inspektoriati Shtetëror i Punës, nën Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale, është përgjegjës për zbatimin e kërkesave për moshën e lejuar për punësim nëpërmjet gjykatave, por Inspektoriati Shtetëror i Punës nuk e zbatoi ligjin sa duhej. Inspektorët e punës hetuan sektorin formal të punës ndërsa fëmijët në pjesën më të madhe të rasteve punësoheshin në tregun joformal. Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u bë në fabrika këpucësh dhe tekstilesh dhe në firma pakice; zyrtarët gjetën disa raste fëmijësh të punësuar gjatë këtyre inspektimeve. Dënimet për shkeljen e ligjit përfshijnë gjoba deri në 50 fishin e pagës minimale; ato nuk qenë të mjaftueshme për të shkurajuar shkeljet.

Në vitin 2013 agjencia qeveritare e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës raportuan se 54.000 fëmijë brenda vendit ishin të angazhuar në punë të detyruar. Llogaritet të jenë rreth 43.000 fëmijë që punonin në ferma dhe peshkim, 4.400 në sektorin e shërbimeve dhe 2.200 në hotele dhe restorante. Afro 7 për qind e fëmijëve ishin nën moshën e lejuar për punë.

Qeveria përmirësoi bashkëpunimin mes inspektoratit të punës dhe njësive bashkiake për të drejtat e fëmijëve, duke trajnuar 50 inspektorë për monitorimin e punës së të miturve.

Ligji dënon penalisht shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyruara, por qeveria nuk e zbatoi në mënyrë të efektshme ligjin. Raportet vërejtën se pjesa më e madhe e të miturve të punësuar punonin si shitës në dyqane, lypës, fermerë, barinj, shpërndarës droge, larës automjetesh, punonjës në fabrika tekstile, minatorë ose lustraxhinj. Disa prej fëmijëve që lypnin në rrugë ishin brez i dytë ose i tretë lypësish. Kërkimet tregojnë se lypja fillonte që në moshën katër ose pesë vjeç. Ndërkohë që kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk e zbatoi ligjin, pavarësisht përpjekjeve më të mëdha për ta bërë këtë gjatë vitit (shikoni seksionin 6, fëmijët e zhvendosur).

Shikoni gjithashtu *Të dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve* të Departamentit të Punës në faqen e internetit www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në Lidhje me Punësimin ose Vendin e Punës

Ligjet e punës ndalojnë diskriminimin në punësim për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, paaftësisë fizike ose mendore, bindjeve politike, kombësisë, besimit, familjes dhe origjinës sociale. Ligjet nuk ndalojnë në mënyrë specifike diskriminimin në

punësim ose vendin e punës lidhur me orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor, statusin e të qenit HIV-pozitiv, gjuhës ose statusit social. Diskriminimi në punësim dhe në vendin e punës ndodhi në lidhje me gjininë, praninë e aftësive të kufizuara, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, kombësinë dhe përkatësinë etnike (shikoni seksionin 6).

e. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte 22.000 lekë (214 dollarë) në muaj. Sipas agjencisë qeveritare të statistikave, paga mesatare për punonjësit e qeverisë në fund të vitit 2013 ishte 52.150 lekë (508 dollarë) në muaj. Kundrejt kësaj, pragu i varfërisë në rang kombëtar në vitin 2013 ishte 6.665 lekë (65 dollarë) në muaj. Agjencia e statistikave raportoi se pagat mesatare mujore në sektorin publik në fund të vitit 2013 ishin rritur me 4,1 për qind krahasuar me fundin e vitit 2012. Kodi i punës kërkon pagesë të njëjtë për punë të barabartë.

Inspektoriati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e pagës minimale. Ndërkohë që ligji përcakton javën e punës me 40 orë, janë marrëveshjet individuale apo kolektive ato që në të vërtetë caktojnë javën e punës. Ligji përcakton pushime të paguara vjetore, por vetëm punonjësit në tregun formal të punës patën të drejta të garantuara për pushime të paguara. Shumë punonjës punonin gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesë për punë jashtë orarit ose në ditët e pushimeve, por punëdhënësit nuk i merrnin parasysh gjithmonë këto dispozita. Ligji kufizon numrin maksimal të orëve të punës në javë deri në 40 dhe parashikon pagesë shpërblyese për punën jashtë orarit. Qeveria nuk kishte standarde për një numër minimal orësh pushimi në javë dhe rrallë zbatoi ligjet që kishin të bënin me orët maksimale të punës, kufirin për orë pune jashtë orarit, apo pagesën ekstra për punën jashtë orarit veçanërisht në sektorin privat. Këto ligje shpesh nuk funksiononin për punonjësit në sektorin joformal si punonjësit në shtëpi dhe punonjësit migrantë.

Inspektoriati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Në përgjithësi, zbatimi mungonte. Kushtet në vendin e punës në sektorët e prodhimit, ndërtimit dhe minerar, shpesh ishin shumë të këqija dhe në disa raste të rrezikshme. Burimet dhe inspektimit shpesh nuk ishin të përshtatshme dhe ndëshkimi me deri 50-fishin e pagës minimale ($10,000) shpesh i frenuan shkeljet, sepse agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për të zbatuar mbledhjen e gjobave dhe si rrjedhojë rrallë ngritën akuza për kundravajtje. Nuk pati programe qeveritare për sigurimin e mbrojtjes sociale për punonjësit në ekonominë joformale.

Shkeljet më të shpeshta të standardeve të sigurisë profesionale dhe pagave, ndodhën në industritë tekstile dhe ato të këpucëve, ndërtim, si edhe në miniera. Punonjësit shpesh nuk mundën ta largonin veten prej situatave që rrezikonin shëndetin ose sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Punëdhënësit nuk i mbronin në mënyrë të efektshme punonjësit në këtë situatë.

###